

Letër mbështetëse për aktivistët Adriatik Gacaferi dhe Shpresa Loshaj

Ne, të poshtënjshkruarit, shprehim shqetësimin tonë për trendin e ri të përdorimit të Padive Strategjike Kundër Pjesëmarrjes Publike (SLAPP) dhe letrave tjera kërcënuese kundër aktivistëve dhe gazetarëve. Së fundi, aktivistët Adriatik Gacaferi dhe Shpresa Loshaj, të cilët angazhohen në mbrojtjen e natyrës në Deçan, janë duke u ballafaquar me padi SLAPP për shkak të aktivizimit të tyre në interes të mbrojtjes së natyrës.

Përmes kësaj letre publike, ne shprehim mbështetjen tonë të plotë ndaj dy aktivistëve dhe kauzave të tyre, si dhe kërkojmë nga kompania KELKOS Energy Sh.P.K (me numër identifikues 810796005) që menjëherë dhe pa vonesë të tërheqë paditë SLAPP të bëra ndaj dy aktivistëve, padi këto që synojnë heshtjen dhe frikësimin jo vetëm të tyre por të secilit aktivist që guxon t'i kundërshtojë hidrocentralet.

Padia e parë për 'shpifje' kundër aktivistit Adriatik Gacaferi është ushtruar nga kompania KELKOS ENERGY Sh.P.K, më 31 janar 2020 përmes avokatit Arianit Koci. Kompania pretendon që një foto e shoqëruar me një koment kritik dhe e publikuar nga Gacaferi më 1 nëntor 2019 në llogarinë e tij private në Facebook,¹ ia ka dëmtuar reputacionin. Kompania kërkon nga Gacaferi: 10 mijë euro dëmshpërblim, largimin e statusit nga Facebook dhe publikimin për 12 muaj të një deklaratë mohuese. Rasti pritet të gjykohet nga gjykatësi Nexhat Musaj në Gjykatën Themelore, dega në Deçan.

E njëjta kompani, KELKOS ENERGY Sh.P.K, përmes avokatëve Arianit Koci dhe Granit Vokshi, ka paralajmëruar padi për shpifje ndaj themelueses së organizatës joqeveritare "Pishtarët" Shpresa Loshaj. Në letrën e tyre, avokatët në emër të kompanisë shkruajnë "... kërkohet që të ndërpritni prirjet tuaja shpifëse dhe t'i kërkonit falje Kelkos Energy në një deklaratë me shkrim, për shkaktimin e dëmeve të pariparueshme të reputacionit të saj. Përndryshe, klienti ynë do të vazhdojë të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme ligjore për të ruajtur statusin e tij si një investitor i respektuar dhe një kontribuues i shkëlqyeshëm për mirëqenien e qytetarëve të Republikës së Kosovës." Paralajmërimi për padi është bërë më 26 qershor 2020, pasi aktivistja Loshaj kishte draftuar një reagim në mbrojtje të ujit në komunën e Deçanit i cili është duke u shfrytëzuar për hidrocentrale.

Ne konsiderojmë që të dy paditë janë padi SLAPP, të cilat po që se do të ishin të suksesshme në gjykatë do të përbënin kërcënim të demokracisë dhe të drejtës së lirisë së shprehjes së aktivistëve. Ftojme aktivistët dhe gazetarët që të mos dekurajohen nga këto padi dhe ne përkushtohemi të sigurojmë ndihmë dhe mbështetje praktike për të gjithë viktimat e padive SLAPP.

¹ Komenti i kontestuar: "*Hidrocentrali Lumbardhi 2 ne Gryken e Deçanit, sot rreth ores 14:30 duke e futur 100% te ujit ne gypa edhe pse ne marrveshjen qe ka me Ministrine e Mjedisit eshte i obliguar qe te pakten 30% te ujit ta le gjithmone ne shtratin e lumit. Sikur te kishet pasur nje gjykate qe do i mbronte kafshet e egera dhe peshqit, Kelkos Energy(pronari e HEC) do ishte denuar per gjenocid ndaj kafsheve dhe peshqiv*"

<https://www.facebook.com/photo.php?fbid=10217462202246141&set=a.1125747663059&type=3&theater>

Informacion shtesë rreth padive SLAPP

Vitet e fundit është paraqitur një trend negativ i përdorimit të padive SLAPP. Politikanët dhe biznesmenët e fuqishëm, nëpërmjet padive që nuk kanë bazë dhe shans për sukses, kërkojnë nga gazetarët, mediat dhe aktivistët qindra mijëra e deri në miliona euro dëmshpërblime në emër të “cenimit të reputacionit”.

Paditë SLAPP janë padi që prima facie vërehen se nuk janë të bazuara në fakte dhe se do të jenë të pasuksesshme në gjykatë. Përmes tyre, paditësi ka për qëllim që të frikësojë dhe dekurajojë gazetarët apo aktivistët nga raportimi dhe shprehja e opinioneve për çështje me interes publik duke i detyruar ata të kalojnë nëpër procese të gjata dhe të kushtueshme gjyqësore. Këto padi konsiderohen dhe duhet të trajtohen si abuzim i legjislacionit kundër shpifjes nga njerëzit dhe korporatat e fuqishme për të heshtur gazetarët, mediat, organizatat e shoqërisë civile dhe aktivistët.

Akterët relevantë në Kosovë duhet të bëhen pjesë e diskutimeve aktuale në këtë fushë, në mënyrë që të sigurohen që paditë SLAPP të mos përdoren për të kufizuar të drejtën e lirisë së shprehjes së gazetarëve dhe aktivistëve.

Unë sot këtu përfaqësoj zërin e dhjetëra organizatave të shoqërisë civile dhe aktivistëve të ndryshëm të cilët i japin mbështetje Adriatikut dhe Shpresës në këtë rast.

Përveç mbështetjes për dy aktivistët, ne shprehim shqetësimin tonë për trendin e përdorimit të padive strategjike kundër pjesëmarrjes publike ndaj aktivistëve dhe gazetarëve. Po ashtu konsiderojmë se paditë SLAPP nëse do të ishin të suksesshme në Gjykatë do të përbënin një kërcënim të demokracisë dhe të drejtës së lirisë së shprehjes.

Koalicioni Ad-Hoc përbëhet nga: Lëvizja FOL, Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF), Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS), Debate Center, D4D, KFOS, OJQ Era, Flutura Kusari, Ardian Nrecaj, Çohu!, Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP), Demokraci Plus, Nisma për të Drejtat e Njeriut - Kosovë (YIHR), Grupi për Mbrojtjen e Ujërave dhe Mjedisit, Kosovo Mountain Club, Instituti i Kosovës për Drejtësi, Instituti GAP, BIRN Kosova, Internews Kosova, Pishtarët, Instituti EPIK, Syri i Vizionit, CEL Kosova, KEN Network, Integra, Sbunker, Organizata EcoZ, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, Shoqata e Intelektualeve të Pavarur në Deçan, Albert Heta, Qendra Kosovare për Studime Gjinore, OJQ TOKA, GAIA Kosova, INJECT, Rrjeti i Grave të Kosovës, Qendra për Zhvillimin e Grupeve Shoqërore - CSGD, Community Building Mitrovica, ADMOVERE, KMDLNj, Let's Do It Peja, Ec ma Ndryshe, POLIS, 'Ecopana', Let's do it Kosova.